



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 17.2.2023

Nr: 59

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 3 SHKURT – 9 SHKURT 2023**

Sot, më datë 17.2.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBEKT: Kryeministria, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Elbasan, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Këshilli i Qarkut Berat, Bashkia Berat, Bashkia Durrës, Bashkia Fier, Bashkia Kavajë, Bashkia Kuçovë, Bashkia Lushnje, Bashkia Vorë.

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të organeve publike për periudhën 3 shkurt deri më 9 shkurt 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 3 shkurt deri më 9 shkurt 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 225 aktivitete, nga 47 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se 40 aktivitete të zhvilluara nga 19 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Në datë 10.2.2023, administrata e KQZ i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 15.2.2023, ora 11:00. Palët e interesuara deponuan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon;

1. Kryeministria ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 4 (katër) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet "Inspektim/Kontroll", raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023,
 - Aktivitet "Inspektim/Kontroll", raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023,
 - Aktivitet "Inspektim/Kontroll", raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
 - Aktivitet "Inspektim/Kontroll", raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Kryeministria nëpërmjet email-it të datës 10.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *"4 (katër) aktivitetet e raportuara me vonesë janë ripublikim i aktiviteteve të raportuara në datën 3 shkurt 2023"*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se raportimi fillestar për këto aktivitete është kryer brenda afatit ligjor, por për shkak të shtyrjes së datës së zhvillimit të aktivitetit nga institucioni dhe ripublikimit të tij në sistem, rezulton me vonesë. Pavarësisht kësaj, në rihedhjen e të dhënave nga Kryeministria është theksuar "riublikim" dhe gjithashtu nga administrata e KQZ është mbajtur shënim rasti. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk ndodhemi përpara kundërvajtjes administrative për aq kohë sa veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.
- Aktivitet “Tjetër/Lidhje marrëveshje”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.
- Aktivitet “Tjetër/Shpallje konkursi”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet email-it të datës 13.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Aktivitetet “Inspektim/kontroll” dhe “Lidhje marrëveshje”, nuk janë zhvilluar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit por do të zhvillohen më vonë, për të cilat do të bëhet raportimi në KQZ, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Për aktivitetin “Shpallje konkursi” pretendojnë se ky aktivitet është njoftuar më parë nga AKPT si shpallje konkursi në rrjetet sociale, dhe MAS e ka raportuar këtë aktivitet, të raportuar më parë, nga ky institucion. Bashkëlidhur ftesa nga AKPT”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se aktivitetet *“Inspektim/Kontroll” dhe “Lidhje marrëveshje”* nuk janë zhvilluar. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaritë nuk janë zhvilluar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për aktivitetin *“Shpallje konkursi”*, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se Ministria e Arsimit dhe Sportit ndodhet në cilësinë e institucionit të ftuar dhe ka qenë në pamundësi për të respektuar afatin ligjor të raportimit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

3. Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tjetër/Takim diplomatik”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, nëpërmjet email-it të datës 14.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se: *“Aktivitetin me temë “Tjetër/Takim diplomatik”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi 10.2.2023, e kemi konsideruar dhe ditën e raportimit, në numërim të afatit 5 ditor.”*

Data: 17.2.2023 Nr: 59
Ora: 11:00



Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 3 shkurt - 9 shkurt 2023”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, nisur nga tematika dhe nga sa informacion jepet në njoftimin e kryer në ndërfaqe, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria e raportuar.

4. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet "Tjetër/Intervistë", raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.
- Aktivitet "Tjetër/Intervistë", raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet shkresës nr. 864 prot., datë 15.02.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, "*Aktiviteti "Tjetër/Intervistë", raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi 10.2.2023, është një intervistë për promovimin e nismës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për regjistrimin e produkteve tradicionale dhe për të informuar prodhuesit e produkteve potenciale për regjistrim mbi këtë nismë. Njoftimi për këtë aktivitet është bërë menjëherë pas mbërritjes së ftesës. Aktiviteti "Tjetër/Intervistë", raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi 8.2.2023, është kërkuar me urgjencë nga televizioni për të folur mbi çështjet e aktualitetit në bujqësi, sidomos për të informuar publikun mbi masat e marra pas situatës emergjente, të krijuar nga temperaturat e ulëta në vend, të cilat prekën veçanërisht sektorin e blegtorisë. Njoftimi është bërë menjëherë pas mbërritjes së ftesës nga televizioni."*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se aktiviteti i parë i raportuar ka objekt *intervistë mbi punën e bërë nga ministria për certifikimin e produkteve tradicionale* në televizionin Klan, me folës kryesorë Ministër Frida Krifca, me pjesëmarrës Ministrja e Bujqësisë, prodhues të produkteve tipike të regjistruara. Në këtë raportim deklarohet se do të jetë pjesëmarrëse media por nuk do të jetë i hapur për publikun.

Për aktivitetin e dytë të raportuar ka objekt *intervistë mbi situatën e aktualitetit në bujqësi pas motit të ftohtë, në televizionin Abc news*, me folës kryesorë Ministër Frida Krifca, me pjesëmarrës Ministër, gazetarë. Në këtë raportim deklarohet se do të jetë pjesëmarrëse media por nuk do të jetë i hapur për publikun.

Për sa më lart, nisur nga tematika e aktiviteteve dhe nga sa informacion jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

5. Ministria e Drejtësisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tjetër/Takim pune”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Ministria e Drejtësisë nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në ndërfaqe, konstaton se aktiviteti ka objekt “*takim pune*” duke shënuar te raportimi “*kërkojmë mirëkuptimin tuaj pasi ky takim pune mbi pagat e magjistratëve ishte i paparashikuar dhe u konfirmua jashtë agjendës*”, i cili do të zhvillohej te Ministria e Drejtësisë, me folës kryesorë Z. Ulsi Manja, znj. Delina Ibrahimaj, me pjesëmarrës Ministër i Drejtësisë, Ministër i Financave. Në këtë raportim deklarohet se nuk do të jetë pjesëmarrëse media dhe nuk do të jetë i hapur për publikun.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se nisur nga tematika e aktivitetit dhe informacioni që jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 5.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet email-it të datës 15.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: “*Aktiviteti i datës 7 shkurt 2023, i raportuar prej jush, si një aktivitet jashtë afateve ligjore, është organizuar nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike dhe Çertifikimit Elektronik (AKCESK). Kjo gjë është pasqyruar nga ana jonë edhe në raportimin e lajmit në faqen e KQZ. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nuk ka qenë institucioni organizator i aktivitetit.*”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

7. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ndërgjegjësues/informues”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.

Ministria e Kulturës, nëpërmjet email-it të datës 14.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“aktiviteti i raportuar me vonesë nuk është një veprimtari me karakter publik, i planifikuar për t’u organizuar nga Ministria e Kulturës apo institucionet e saj të varësisë. Prezenca e Ministres së Kulturës ka pasur statusin e të ftuarit.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Ministria e Kulturës ka qenë në pamundësi për të përmbushur afatin ligjor për të raportuar këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

8. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet email-it të datës 15.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar maksimalisht për raportimin në kohë dhe shterues të të gjitha aktiviteteve me karakter publik në përputhje me nenin 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, por duke marrë në konsideratë dinamikat dhe rrethanat të cilat ndonjëherë janë përtej mundësive tona parashikuese, mund të ndodhin ndryshime të momenteve të fundit në agjendën e Ministres. Megjithatë, ne jemi munduar ti paraprijmë këtyre ndryshimeve duke raportuar çdo aktivitet me karakter publik. Në lidhje me aktivitetet e sjella ne vëmendje, ju bëjmë me dije se: Aktiviteti “Inspektim kontroll”, raportuar në datën 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023 është supozuar që numërimi i 5 ditësh-it përfshin edhe ditën e zhvillimit të aktivitetit ndaj në perceptimin tonë, aktiviteti është lajmëruar në afat.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se vonesa e raportimit të veprimtarisë publike ka ardhur nga llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit.

Për këtë arsye, duke u përpjekur për të mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, i tërheqim vëmendjen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që në vijim, të kryejnë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se *raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.*

9. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tjetër/Ambasada Hollandeze mbështet Sistemin e Burgjeve”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet email-it të datës 13.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“raportimi është bërë me vonesë sepse veprimtaria (aktivitet donacioni nga Ambasada Hollandeze që mbështeti sistemin e Burgjeve), u kërkua në këtë datë nga Ambasada Hollandeze, në kuadër të një Donacioni të bërë prej tyre për Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë. Kjo veprimtari lidhet me një dërgesë me materiale, pajisje, krevat për të dënuarit, nga Departamenti i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Stokut të Agjencisë së Institucioneve të Kujdestarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë Hollandeze, si dhe Ambasadës Hollandeze në Shqipëri. Materialet ishin të ngarkuara në një trajler dhe ne ishim të kushtëzuar që shkarkimi i tyre të bëhej në një kohë sa më të shpejtë, që t’i jepnim mundësi mjetit të kthehej në vendin e origjinës. Ky aktivitet nuk është publikuar në faqen zyrtare apo në rrjete sociale.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatoi se tematika e aktivitetit “Ambasada Hollandeze mbështet sistemin e burgjeve”, që është raportuar jashtë afatit ligjor, për sa informacion jepet në ndërfaqe, lidhet me ushtrimin e detyrave funksionale të institucionit dhe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka kjo veprimtari.

10. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Elbasan ka raportuar nëpërmjet shkresës nr. 695 prot., datë 8.2.2023, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

Data: 17.2.2023 Nr: 59
Ora: 11:00



Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 3 shkurt - 9 shkurt 2023”

- Aktivitet “Takim informues”, raportuar në datë 8.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Elbasan nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të dhënat e raportuara nëpërmjet shkresës konstaton se objekti i veprimtarisë është *takim informues midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqatës Save the Children, në kuadër të bashkëpunimit dhe informimit në lidhje me kurset profesionale që zhvillohen në këtë qendër. Ky takim do ketë si fokus, kërkesën tonë kundrejt Bashkisë dhe Shoqatës për përforcimin e kontakteve të vazhduar për promovimin e këtyre kurseve. Në raportimin e kryer, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Elbasan, nuk ka deklaruar pjesëmarrësit apo nëse takimi është i hapur për publikun ose jo.*

Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga sa informacion jepet në njoftimin e kryer, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

11. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ndërgjegjësues/Informues”, raportuar në datë 06.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës nëpërmjet email-it të datës 10.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“ky aktivitet është bashkëorganizuar me Kryeministrinë dhe është raportuar nga zyra përkatëse e Kryeministrisë. Menjëherë më pas, e kemi raportuar edhe ne, por vonesa ka ardhur për shkak të llogaritjes së gabuar të ditëve, duke raportuar 4 ditë para dhe jo 5 ditë, si e përcakton ligji”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se në kushtet kur raportimi i aktivitetit është kryer brenda afatit ligjor nga njëri prej institucioneve organizatore të aktivitetit, krijon bindjen se është përmbushur detyrimi i përcaktuar sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

12. Këshilli i Qarkut Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tjetër/Takim me partneret e projektit”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 9.2.2023.

- Aktivitet “Tjetër/Marrje vendimesh”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.

Këshilli i Qarkut Berat, nëpërmjet email-it të datës 13.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se: *“Aktiviteti Tjetër/Takim me partnerët e projektit”, ka qenë i pamundur të bëhej më parë, pasi jemi bërë me dije për zhvillimin e tij në datë 6.2.2023, provuar kjo edhe me ftesën e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Pjesëmarrja e titullarit të institucionit në këtë takim ishte i rëndësishëm, pasi ishte një takim me të gjithë partnerët pjesë e implementimit të projektit të financuar nga fondet e BE. Për aktivitetin “Tjetër/Marrje vendimesh”, raportuar datë 6.2.2023, sqarojmë se mbledhjet e Këshillit të Qarkut zhvillohen sipas programit të punës që ka institucioni, të cilat rregullohen me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore” dhe këto mbledhje nuk janë aktivitete që zhvillohen me qëllim krijimi informacioni për publikun, por janë të detyrueshme dhe vendimmarrëse për ecurinë dhe zhvillimin normal të institucionit. Duke mos qenë të qartë nëse duhej raportuar apo jo, mbledhja e këshillit, është bërë raportimi me vonesë.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se për aktivitetin “Tjetër/Takim me partnerët e projektit” Këshilli i Qarkut Berat nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për aktivitetin “Tjetër/Marrje vendimesh”, referuar tematikës së tij “Mbledhjet e Këshillit të Qarkut”, në vetvete, përbëjnë veprimtari administrative që lidhen me veprimtarinë funksionale të institucionit.

13. Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 6.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.

Bashkia Berat nëpërmjet shkresës me nr. 888 prot., datë 16.02.2023 ka dërguar pretendimet e saj si dhe gjithashtu përfaqësuesi i autorizuar i saj ishte i pranishëm në seancën publike të datës 15.2.2023 dhe arsyetoi se: *“Aktiviteti i raportuar “Inspektim” është një vijueshmëri e punës rutinë i cili ishte planifikuar për tu zhvilluar në datë 5.2.2023 por nuk është zhvilluar dhe as nuk është publikuar në faqen zyrtare të institucionit, media apo rrjete sociale.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se, aktiviteti i raportuar me vonesë nuk është zhvilluar dhe në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

14. Bashkia Durrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 11 (njëmbëdhjetë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.
2. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 4.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.
3. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 4.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.
4. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 4.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.
5. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 4.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.
6. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
7. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
8. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
9. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
10. Aktivitet “Tjetër/Takim në zyrë”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 9.2.2023.
11. Aktivitet “Aktivitet ndërgjegjësues/Informues”, raportuar në datë 7.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 9.2.2023.

Nëpërmjet email-it të datës 14.2.2023, Bashkia Durrës ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se:

Aktiviteti “Inspektim/Kontroll” me objekt “Vizitë në Spitalin Rajonal Durrës dhe në disa Qendra shëndetësore”, kryetari i Bashkisë Durrës, zj. Emiriana Sako ka qenë e ftuar në këtë aktivitet nga organizatorët e saj dhe ftesa për pjesëmarrjen ka ardhur në datë 2.2.2023.

Aktiviteti “Inspektim/Kontroll” raportuar në datë 4.2.2023, edhe pse është raportuar për t’u zhvilluar në datë 8.2.2023, për shkak të ndryshimit të agjendës së Kryeministrit, ky aktivitet është zhvilluar më datë 7. 2.202, në kuadër të rehabilitimit të zonave urbane në hapësira publike kryesore ku janë inspektuar punimet lidhur me ndërtimin e shëtitores së

Data: 17.2.2023 Nr: 59
Ora: 11:00



Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 3 shkurt - 9 shkurt 2023”

plazhit, aktivitet i cili është organizuar nga Kryeministri, ndërsa Kryetari i Bashkisë ka qenë i ftuar në këtë takim.

Aktiviteti “Inspektim/Kontroll” edhe pse është raportuar për t’u zhvilluar datë 8.2.2023, për shkak të ndryshimit të agjendës së Kryeministrit, është zhvilluar në datë 7.2.2023 në kuadër të inspektim për rikonstruksionin e rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari”, aktivitet i cili është organizuar nga Kryeministri, ndërsa Kryetari i Bashkisë ka qenë i ftuar në këtë takim.

Aktiviteti “Inspektim/Kontroll” edhe pse është raportuar për t’u zhvilluar datë 8.2.2023, për shkak të ndryshimit të agjendës së kryeministrit, është zhvilluar në datë 7.2.2023 në kuadër të inspektimit për rikualifikimin e fasadave të pallateve në bllokun e banimit të lagjes nr.18, ku janë inspektuar punimet lidhur me rikualifikimin e fasadave të këtyre pallateve, aktivitet i cili është organizuar nga Kryeministri, ndërsa Kryetari i Bashkisë ka qenë i ftuar në këtë takim.

Aktiviteti “Inspektim/Kontroll” edhe pse është raportuar për t’u zhvilluar datë 8.2.2023, për shkak të ndryshimit të agjendës së kryeministrit, është zhvilluar në datë 7.2.2023 në kuadër të inspektimit për ndërhyrjet në zonat sportive dhe lodrave për fëmijë “Dua të luaj” si edhe në Parkun e Durrësit “Vala”, ku janë inspektuar punimet lidhur me këto investime, aktivitet i cili është organizuar nga Kryeministri, ndërsa Kryetari i Bashkisë ka qenë i ftuar në këtë takim.

Lidhur me aktivitetet pikat 6,7,8,9 ju informojmë se janë publikuar me datë 4.2.2023, për shkak të ndryshimit të agjendës së kryeministrit, janë zhvilluar në datë 7.2.2023. Në momentin e ndryshimit të aktivitetit bashkia Durrës ka bërë riraportimin e aktivitetit, edhe pse ka qenë e ftuar në këto aktivitete.

Aktiviteti “Tjetër/Takim në zyrë” me objekt “takimin në ambientet e bashkisë me Ambasadorin e Izraelit”, është raportuar në datë 31.1.2023 për t’u zhvilluar në datë 7.2.2023, për shkak të ndryshimit të agjendës, ky aktivitet është zhvilluar në datë 9.2.2023. Ky aktivitet është riraportuar në datë 7.2.2023, por raportimi i parë ka qenë në datë 31.1.2023.

Aktiviteti “Ndërgjegjësues/Informues” me objekt “Aktivitet me rastin e dhurimit të librave nga Ambasadori i Ukrainës për komunitetin ukrainas që jeton në Durrës dhe lexuesve të tjerë”, është raportuar më datë 30. 1.2023 për tu zhvilluar datë 9.2.2023. Ky aktivitet është riraportuar datë 7. 2.2023, por raportimi i parë ka qenë në datë 30.1.2023, pra pesë ditë para zhvillimit të aktivitetit.”

Për 9 (nëntë) veprimtaritë e raportuara me temë “Inspektim/Kontroll”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoi se Bashkia Durrës nuk ka pasur mundësi të raportojë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për aktivitetet me temë “Tjetër/Takim në zyrë” dhe aktivitet “Ndërgjegjësues/Informues” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, vlerëson se raportimi fillestar për këto aktivitete është kryer brenda afatit ligjor, por për shkak të shtyrjes së datës së zhvillimit të aktivitetit nga institucioni dhe ripublikimit të tij, në sistem rezulton me vonesë. Pavarësisht kësaj, në rihedhjen e të dhënave nga Bashkia Durrës është theksuar “ripublikim” dhe gjithashtu nga administrata e KQZ është mbajtur shënim rasti. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor.

15. Bashkia Fier ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tjetër/Vizitë në disa sipërmarrje private në njësinë administrative Mbrostar, për t’u njohur nga afër me sfidat dhe arritjet e tyre”, raportuar në datë 4.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll/Mbjellje pemësh në Mbrostar”, raportuar në datë 4.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.

Bashkia Fier, pas njoftimit të kryer nga KQZ, nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nga rrethanat dhe faktet, konstatohet se Bashkia Fier ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit.

Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, i tërheqim vëmendjen Bashkisë Fier në vijim të kryejnë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

16. Bashkia Kavajë, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

Data: 17.2.2023 Nr: 59
Ora: 11:00



Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 3 shkurt - 9 shkurt 2023”

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.

Bashkia Kavajë, nëpërmjet email- it të datës 15.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Është kryer një lapsus në hedhjen e të dhënave në sistem. Datat janë shënuar gabim duke llogaritur 5 (pesë) ditë edhe ditën e zhvillimit të aktiviteteve”*.

Konstatohet se Bashkia Kavajë ka kryer një lapsus, duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit.

Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, i tërheqim vëmendjen Bashkisë Kavajë në vijim të kryejnë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

17. Bashkia Kuçovë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Aktivitet ndërgjegjësues/Informues”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.
- Aktivitet “Aktivitet ndërgjegjësues/Informues”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.

Bashkia Kuçovë, nëpërmjet email- it të datës 13.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Së pari, institucioni ynë ka pasur probleme për të hyrë në ndërfaqen e raportimit të aktiviteteve. Kemi komunikuar me email-in me KQZ-në, bashkëlidhur komunikimi. Së dyti, aktiviteti “Takim me të rinjtë e KVR dhe Qendrës Rinore”, nuk ishte një organizim i Bashkisë Kuçovë, por ishte një organizim i OJQ New Bridge, Lëviz Albania dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Ky aktivitet ishte raportuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nuk ishim të sigurt nëse duhet ta raportonim edhe ne. Sa i përket aktivitetit tjetër “Takim në Shkollën e Bashkuar Perondi”, sqarojmë se ky aktivitet na është njoftuar momentin e fundit nga Z.V.A Kuçovë dhe nuk ishte aktivitet i yni, ishim thjesht pjesëmarrës. Ky aktivitet u anulua dhe do të zhvillohet një moment tjetër. Së treti, theksojmë se kryetari i Bashkisë merr pjesë në aktivitete duke kryer detyrat funksionale në këtë cilësi dhe jo si kandidat. Së katërti, sipas*

Data: 17.2.2023 Nr: 59
Ora: 11:00



vendimit nr. 9 datë 29.1.2022 të KRR, duhet

Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 3 shkurt - 9 shkurt 2023”

të përmbushen dy kushte që titullari të dënohet me masë administrative: 1- aktiviteti të jetë raportuar përtej afatit ligjor dhe 2- titullari i institucionit të ketë ndikuar apo urdhëruar raportimin me vonesë. Nuk ka asnjë provë që kryetari të ketë ndikuar apo urdhëruar raportimin me vonesë.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Bashkia Kuçovë nuk ka pasur mundësi të raportoje për këto aktivitete, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

18. Bashkia Lushnjë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 3.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.

Bashkia Lushnjë, nëpërmjet email- it të datës 13.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Për aktivitetin inspektim në subjektin Agropërpunues Zdrava sh.p.k për datën 31.01.2023, nuk u krye dhe u shty për një datë tjetër pa na u dhënë data e dytë. Sapo jemi njoftuar për vizitën e Ministres së Bujqësisë dhe Kryeministrit në qytetin e Lushnjës për ditën e hënë, datë 6.2.2023, kam bërë raportimin te rubrika e aktiviteteve për një ripublikim të aktivitetit të programuar për datë 31. 1.2023 i cili nuk u zhvillua atë datë, por sapo morëm njoftim që do të zhvillohet datë 6. 2.2023, menjëherë kemi raportuar dhe me email për këtë njoftim të menjëhershëm. Bashkëlidhur kopje email-it.” Gjithashtu pretendojnë se kanë qenë të ftuar në këtë aktivitet dhe nuk është organizuar nga ana e tyre.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Bashkia Lushnjë, nuk ka pasur mundësi të raportoje për këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

19. Bashkia Vorë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 8.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 11.2.2023.

Bashkia Vorë, nëpërmjet email- it të datës 13.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se *“ky aktivitet, pas verifikimit të afatit ligjor të raportimit, nuk është zhvilluar dhe për rrjedhojë nuk ka pasur asnjë publikim në rrjete sociale dhe as në faqen zyrtare të Bashkisë Vorë.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se në kushtet kur aktiviteti nuk është zhvilluar, nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa shkelja nuk është kryer.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOS:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:

- a) Kryeministrisë,
- b) Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,
- c) Ministrinë të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin,
- ç) Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- d) Ministrisë së Drejtësisë,
- dh) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,
- e) Ministrisë së Kulturës,
- ë) Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
- f) Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve,
- g) Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Elbasan
- gj) Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës,

Data: 17.2.2023 Nr: 59
Ora: 11:00



Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 3 shkurt - 9 shkurt 2023”

- h) Këshillit të Qarkut Berat,
- i) Bashkisë Berat,
- j) Bashkisë Durrës,
- k) Bashkisë Fier,
- l) Bashkisë Kavajë,
- ll) Bashkisë Kuçovë,
- m) Bashkisë Lushnjë,
- n) Bashkisë Vorë.

2. Tërheqje vëmendje ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkisë Fier dhe Bashkisë Kavajë, që të marrin masa të menjëhershme dhe të kryejnë saktë llogaritjen e afatit 5 ditor, sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor.
3. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI